



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 609 Prot.

Tiranë, më datë 03.06.2022

VENDIM
Nr. 230, datë 03.06.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 "*Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë*", neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 "*Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale*", Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 "*Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj*", pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 03.06.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor realizuar nga individ i licencuar në arkeologji, z. Taulant Rama, në kuadër të projektit "*Parku fotovoltaiik Dimax Albania 2 MW Povelçe Fier*" me aplikues dhe zhvillues Dimax Albania.
2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve për projektin "*Parku fotovoltaiik Dimax Albania 2 MW Povelçe Fier*" si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje arkeologjike rastësore, në zbatim të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, "*Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë*", nenet 145-147, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohet pranë IKTK-së;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

